



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 17

21 shkurt

2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 50, datë 5.2.2014	Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit	327
Vendim i KM nr. 54, datë 5.2.2014	Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfileozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore	336
Vendim i KM nr. 56, datë 5.2.2014	Për shfuqizimin e vendimit nr. 600, datë 12.9.2007 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, të ndryshuar	346
Vendim i KM nr. 58, datë 5.2.2014	Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. Tf013194, të Fondit Global të Mjedisit (GEF), ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit “Raportimi për konventat, harmonizimi i planit kombëtar të veprimit për të luftuar shkretëtirëzimin në shqipëri dhe përgatitjen e raportit kombëtar”	346

VENDIM
Nr. 50, datë 5.2.2014

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR PARANDALIMIN DHE SHLYERJEN E
DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA E TË PLANIT TË VEPRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 185/2013 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit, sipas dokumentit bashkëlidhur, që është pjesë përbërëse e tij.
 2. Miratimin e rregullave, të procedurave dhe të kriterëve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të qeverisjes qendrore, si pjesë e strategjisë.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për ngritjen e njësisë së posaçme të administrimit e të monitorimit të detyrimeve të prapambetura dhe nxjerrjen e udhëzimeve në zbatim të këtij vendimi.
 4. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

STRATEGJIA
PËR PARANDALIMIN DHE SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA
DHE PLANI I VEPRIMIT

LISTA E AKRONIMEVE

APP - Agjencia e Prokurimeve Publike
DPT - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
KPD - Komiteti i Detyrimeve të Prapambetura
KLSH - Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM - Këshilli i Ministrave
MF - Ministria e Financave
NPA - Nëpunësi i parë autorizues, sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Financave
Nëpunës autorizues-sekretari i përgjithshëm në ministrinë dhe institucionet qendrore, drejtuesit e institucioneve të vartësisë
Nëpunës zbatues-drejtuesi për financave në institucion
TVSH - Tatimi mbi vlerën e shtuar
SPSDP/SPSD - Strategjia i parandalimit dhe shlyerjes së detyrimeve të prapambetura
SIFQ - Sistemi informatik financiar i qeverisë

PËRMBLEDHJE

Përmbajtja e dokumentit: Kjo strategji përcakton rrugën që do të ndjekë qeveria shqiptare për të paguar detyrimet financiare të prapambetura të njësisë të qeverisjes qendrore, si dhe masat që do të ndërmerren për të parandaluar krijimin e detyrimeve financiare të prapambetura në të ardhmen për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Objektivat e strategjisë:

Objektivi 1. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura në mënyrë të saktë, transparente dhe të besueshme.

Objektivi 2. Forcimi i disiplinës financiare për të parandaluar akumulimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen.

Aktorët kryesorë: rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e strategjisë:



Ministri i Financave si udhëheqës dhe monitorues i procesit.

Titullarët e institucioneve të qeverisjes qendrore për sigurimin e verifikimit të plotë të saktësisë së pretendimeve për detyrime të pashlyera.

Nëpunësi i parë autorizues për organizimin dhe ndjekjen e procesit.

Nëpunësit autorizues dhe zbatues për identifikimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura të institucioneve që mbulojnë, si dhe raportimin e tyre në degët e thesarit dhe te nëpunësi i parë autorizues.

Komiteti i Detyrimeve të Prapambetura për miratimin përfundimtar të detyrimit për t'u paguar dhe ndjekjen e shlyerjes së detyrimit financiar të prapambetur.

Agjencia e Prokurimit Publik për t'u siguruar që përpara nisjes së procedurave të prokurimit, çdo urdhër prokurimi i autoriteteve kontraktore të jetë i vulosur nga degët e thesarit ku ushtron aktivitetin njësisë e qeverisjes së përgjithshme. Kjo provon që çdo proces tenderimi bazohet në fonde buxhetore të miratuara dhe në dispozicion të njësisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për identifikimin dhe vlerësimin e pretendimeve për rimbursimin e TVSH-së dhe tepricës kreditore të tatimit mbi fitimin.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për detyrimet e prapambetura në lidhje me pretendimet e përfitimit për personat me aftësi të kufizuar.

Gjatë procesit, Ministria e Financave do të mbikëqyret nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, bazuar në një marrëveshje institucionale, si dhe nga një audit ndërkombëtar për të siguruar procesin dhe publikun mbi transparencën dhe paanësinë e kryerjes së procedurave të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.

Shlyerja e detyrimeve financiare të prapambetura është parashikuar të përfundojë brenda tri viteve të ardhshme, që përkon me fundin e vitit 2016.

A. Hyrje dhe të dhëna paraprake

1. Në shtator 2013, qeveria filloi vlerësimin e detyrimeve financiare të pashlyera me qëllim shlyerjen e tyre në një kohë sa më të shpejtë. Fillimisht në muajin tetor 2013 u kontraktua një shoqëri e pavarur për të ndërmarrë një proces kontrolli dhe për të nxjerrë gjendjen përfundimtare në lidhje me kontratat qeveritare të pashlyera deri në fund të gushtit 2013. Detyrimet e prapambetura kontraktuale për investime, të identifikuar për institucionet e qeverisë qendrore, duke shtuar edhe pretendime të sipërmarrjeve, të cilat kërkojnë kontrolle të mëtejshme, vlerësohen të arrijnë 24.6 miliardë lekë. Këto vlerësohen të jenë vetëm një kategori e detyrimeve financiare të prapambetura. Detyrime të prapambetura janë identifikuar dhe në ndërmarrjet shtetërore të shërbimeve publike, ndaj subjekteve tatimpaguesve në procesin e rimbursimit të TVSH-së dhe tatimit-fitimit, detyrime të krijuara si pasojë e vendimeve gjyqësore.

2. Nga vlerësimet paraprake, detyrimet e përgjithshme financiare të prapambetura të qeverisjes qendrore deri në dhjetor 2013 parashikohen të jenë afërsisht 72.6 miliardë lekë ose 5.3 për qind e PBB-së (shih tabelën 1 më poshtë). Kjo shifër do të jetë subjekt i verifikimeve të mëtejshme gjatë procesit të shlyerjes së detyrimeve. Përveç këtyre detyrimeve të prapambetura, mund të ketë edhe detyrime të tjera të konsiderueshme të prapambetura në sektorin më të gjerë publik, duke përfshirë ndërmarrjet shtetërore në sektorin e energjisë.

TABELA 1
NDARJA NË ZËRA E DETYRIMEVE TË PËRGJITHSHME FINANCIARE
TË PRAPAMBETURA TË QEVERISË

Vlerësimi paraprak i detyrimeve financiare të prapambetura	
	miliard lek
Detyrime për projekte investimesh	24.6
Detyrime për mallra dhe shërbime	5
Rimbursim i TVSH-së	12.84
Rimbursim i tepricës kreditore të tatimit mbi fitimin	10
Detyrime për vendime gjyqësore ndërkombëtare	1

Të tjera (vendime gjyqësore, shpronësime publike, përfitimet për persona me aftësi të kufizuar etj.)	19.13
TOTALI	72.57

3. Pjesa e pashlyer e vlerësuar e pretendimeve financiare kundrejt qeverisë në tabelën 1 do të përditësohet për gjendjen që rezulton në datën 31 dhjetor 2013 dhe do të konfirmohet nëpërmjet një procesi verifikimi që do të kryhet nga titullarët e ministrive të linjës dhe krerët e njësive të tjera qendrore, nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave (MF). Gjithashtu, në shtojcën 1 të këtij dokumenti strategjik jepet plani i veprimit për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Ndikimi i detyrimeve financiare të prapambetura në ekonominë shqiptare

4. Paaftësia e një qeverie për të paguar detyrimet e saj financiare, brenda një kohe të shpejtë pasi ato bëhen të kërkueshme, dhe si pasojë dhe akumulimi i një mase të madhe të detyrimeve financiare të prapambetura i shkakton dëm ekonomisë. Ndikimet përfshijnë ngadalësimin e rritjes ekonomike dhe rritjen e papunësisë, për sa kohë bizneset e varura nga kontratat qeveritare pushojnë ose shtyjnë aktivitetin e tyre si rezultat i vonësive në pagesa ose vështirësive në mundësinë e kredive nga bankat tregtare. Shlyerjet e huave kundrejt bankave mund të vuajnë nëse likuiditeti kufizohet si rezultat i rritjes së detyrimeve të prapambetura. Ndikimet mbi likuiditetin në treg mund të jenë gjithashtu të ashpra. Këta faktorë mund të rezultojnë në një ndikim dëmtes mbi kërkesën e përgjithshme dhe mund të kufizojnë aftësinë e qeverisë në përdorimin e politikës fiskale si një mjet për stabilizimin makroekonomik. Nëse furnitorët e qeverisë marrin parasysh mundësinë e vonësive të gjata në marrjen e pagesave, ata mund të përpiqen të ulin riskun dhe koston shtesë të pagesave të vonuara duke rritur përkatësisht çmimet e tyre, duke detyruar kështu qeverinë të paguajë çmimet mbi tregun për shërbimet e ofruara.

5. Një pjesë e rritjes së huave të këqija në sektorin bankar në disa prej viteve të fundit mund t'u atribuohet detyrimeve të prapambetura të qeverisë. Dhënia e shërbimeve publike në disa raste është ndalur plotësisht pasi furnitorët kanë ndërprerë zbatimin e ndërtimit në projektet e investimeve për shkak të mospagesave, duke rezultuar në degradimin e disa investimeve, veçanërisht në sektorin rrugor. Së fundmi, në rastet e vonësive të pagesave të asistencës sociale ka një ndikim të drejtpërdrejtë në shtresat më të pambrojtura të shoqërisë, të cilat vuajnë si pasojë e vonësive në pagesat e përfitimeve.

6. Për pasojë, zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie për eliminimin e pjesës së detyrimeve të prapambetura dhe ndërmarrja e masave për të parandaluar akumulimin e mëtejshëm në të ardhmen do të jetë një hap i rëndësishëm i përpjekjeve të qeverisë për të rikthyer ekonominë të një rritje e fuqishme në të mirë të të gjithë qytetarëve brenda një periudhe afatmesme dhe afatgjatë, si dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të re partneriteti. Seksionet e mëposhtme të këtij dokumenti e shtjellojnë këtë strategji.

Përkufizimi i detyrimeve të prapambetura

7. Për qëllimet e Strategjisë së Parandalimit dhe Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura (SPSD), detyrimet e prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara nga një ligj/kontratë/marrëveshje/vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e qeverisjes qendrore, pushtetit vendor (kontratat e financuara nga qeveria qendrore) dhe fondeve speciale të sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Balanca e verifikuar e pashlyer në datën 31 dhjetor 2013 (si dhe e papaguar gjatë muajit janar 2014) do të përdoret për qëllimin e strategjisë.

8. Në detyrimet e prapambetura të lindura në njësitë e qeverisjes vendore përfshihen vetëm detyrimet për punimet e kryera, por të papaguara në kuadër të financimeve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, si edhe transfertat për përfitimet e paaftësisë. Të gjitha detyrimet e tjera financiare të njësive të qeverisjes vendore, që nuk përfshihen në sa më sipër, duhet të parashikohen në vetë buxhetet e njësive të qeverisjes vendore.

B. Parandalimi i krijimit të detyrimeve të prapambetura në të ardhmen

9. Një shtyllë themelore e strategjisë është parandalimi i rikrijimit të detyrimeve të prapambetura. Për këtë qëllim, qeveria ka zhvilluar një analizë të shkaqeve të pagesave të vonuara dhe do të miratojë masa specifike për të forcuar disiplinën buxhetore, kryesisht në drejtim të planifikimit buxhetor, kontrolleve financiare paraprake dhe rritjen e eficiencës së shpenzimeve. Zbatimi i suksesshëm



i këtyre masave do të kërkojë zbatimin me rigorozitet të kërkesave ligjore nga ana e titullarëve, nëpunësve autorizues, nëpunësve zbatues të njësisve të qeverisjes së përgjithshme dhe stafit mbështetës të tyre. Sanksionet e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi do të zbatohen në rastet e shkeljes së kërkesave ligjore e nënligjore. Masat për forcimin e disiplinës financiare përfshijnë:

9.1 Sigurimin e financimit të mjaftueshëm në vitin ushtrimor dhe në vitet në vazhdim përpara se të fillojë prokurimi, kjo bazuar në disponibilitetin e fondeve buxhetore për të gjitha detyrimet e marra përsipër nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore.

9.2 Si një masë e nevojshme kontrolli, regjistri i prokurimeve të depozitohet zyrtarisht dhe elektronikisht në degën e thesarit, në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe çdo rishikim i tij gjatë vitit. Në çdo rast, shuma totale e prokurimeve të jetë e barabartë ose më e vogël se fondet e miratuara për vitin buxhetor ose për më shumë se një vit (për kontratat shumëvjeçare të investimeve).

9.3 Këshilli i Ministrave do të miratojë kufijtë shumëvjeçarë të angazhimeve, si pjesë të dokumentit të buxhetit afatmesëm dhe në vitin 2015 këta kufij do të miratohen nga Kuvendi si pjesë e ligjit të buxhetit vjetor, pas rishikimit të bazës ligjore për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Mbi këtë bazë edhe respektimi i angazhimeve do të monitorohet dhe kontrollohet nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë (SIFQ).

9.4 Duke filluar nga janari 2014, të gjithë urdhrat e prokurimit për mallrat, shërbimet dhe investimet e nxjerra gjatë vitit, përveç blerjeve emergjente me vlerë nën 10,000 lekë, duhet: i) t'i përmbahen regjistrat të prokurimeve të dorëzuar në thesar; ii) të vulosen nga dega e thesarit të rrethit nëse ka fonde buxhetore në dispozicion të institucionit, përpara procedimit sipas rregullave të prokurimit publik. Për mallrat, shërbimet dhe investimet, për të cilat ka nisur procesi i tenderimit përpara hyrjes në fuqi të strategjisë, do të paraqitet kontrata në degën e thesarit, për t'u kontrolluar kundrejt fondeve disponibël dhe vulosur, përpara nënshkrimit të saj nga nëpunësi autorizues i njësisë. Dega e thesarit refuzon me shkrim një urdhër prokurimi, apo kontratën si më lart, të pambuluar me fonde publike dhe për këtë njofton Agjencinë e Prokurimit Publik, e cila e publikon në faqen e internetit. Kjo iniciativë që i shërben forcimit të disiplinës kontraktuale do të publikohet gjerësisht në komunitetin e biznesit për të siguruar që furnitorët e mallrave dhe shërbimeve të qeverisë të jenë plotësisht në dijeni të kësaj kërkesë, me qëllim që një kontratë qeveritare të konsiderohet ligjërisht e vlefshme.

9.5 Mundësimin e kontrollit të fazës së paraangazhimeve financiare dhe monitorimit të pagesave të pashlyera (duke rishikuar SIFQ për kontrollin e faturave kundrejt fondeve buxhetore vjetore dhe datat e pagesave kundrejt mjeteve monetare të qeverisë). Ministria e Financave ka filluar t'u sigurojë institucioneve të drejtën e përdorimit direkt të sistemit informatik financiar të qeverisë, i cili do të zgjerohet në të ardhmen duke mbuluar kështu 60 për qind të fondeve të buxhetit të shtetit dhe 15 për qind të buxhetit lokal për vitin 2014, dhe 80% të fondeve të buxhetit të shtetit në vitin 2015.

9.6 Monitorimin e akumulimit të detyrimeve të reja të prapambetura. Ministria e Financave do të zhvillojë një sondazh semestral, te ministritë kryesore, nëse ka detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme, që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra pas datës 1 janar 2014 dhe do të zhvillojë një analizë të periudhës së pretendimeve, duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrin ligjor në fuqi.

9.7 Ndryshime në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor, ligjin për menaxhimin dhe kontrollin financiar, ligjin e prokurimeve dhe rregulloret e tyre përkatëse për të realizuar kontrollin e kërkuar dhe kërkesat e raportimit.

9.8 Zbatimin e planeve qeveritare për të forcuar menaxhimin financiar publik në nivelin e qeverisjes vendore, duke filluar nga shtatori 2014 dhe vendosja e kërkesës për njësitë e qeverisjes vendore për të raportuar për kontratat dhe kreditorët.

9.9 Rimbursimi nga sistemi i thesarit i tepricës kreditore të kërkueshme të TVSH-së pas datës 1 janar 2014, sipas procedurës së miratuar me udhëzim të ministrit të Financave.

C. Menaxhimi i procesit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura

10. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura do të menaxhohet në mënyrë transparente nëpërmjet një procesi të miratuar brenda kritereve të vendosura në këtë strategji. Ky proces do të fillojë pasi detyrimet financiare të prapambetura të jenë verifikuar rregullisht dhe masat institucionale për

mbikëqyrjen e procesit të jenë miratuar.

Parashikimi buxhetor

11. Fondet e caktuara për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nuk janë pjesë e buxhetit të miratuar për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme. Buxheti për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura do të identifikohet dhe menaxhohet nga KDP-ja. Fondet buxhetore për çdo kategori miratohen nga ministri i Financave si zë më vete në buxhet dhe rrisin nivelin maksimal të shpenzimeve për çdo njësi të qeverisjes qendrore, mbështetur në masën e detyrimeve të prapambetura që shlyhen, si dhe saktësinë e inventarizimit të detyrimeve për çdo kategori. Parashikimet për vitet në vazhdim do të përfshihen në programin buxhetor afatmesëm. Pagesat e verifikuara dhe të rakorduara do të paguhen brenda një periudhe që nuk i kalon tri vite kalendarike.

**TABELA 2
PARASHIKIMI BUXHETOR AFATMESËM**

	2014	2015	2016	TOTALI
Shpërndarja e buxhetit (miliard lek)	35	20	17.57	72.57

Caktimi i prioriteteve dhe radha e pagesave

12. Parimet në të cilat do të mbështeten këto pagesa do të jenë në mënyrë transparente, proporcionale, të besueshme, realiste dhe të drejtë.

13. Radha e pagesave për secilën kategori të detyrimeve të papaguara do të ndjekë parimin e kohës së krijimit të detyrimit financiar edhe sipas sektorëve. Pagesat do të fillojnë nga detyrimet më të vjetra tek ato më të reja, sipas datave të dorëzimit, vlerësimit dhe aprovimit nga institucionet përkatëse, të dokumentacionit që vërteton kryerjen e punimeve/shërbimeve/dorëzimin e mallrave dhe/ose kërkesën për rimbursimin e TVSH-së, tatim-fitimit. Radha e pagesës do të ndryshojë vetëm nëse ka parregullsi në dokumentacion që kërkon verifikime të mëtejshme.

14. Rimbursimi i TVSH-së dhe tepricës kreditore të tatimit mbi fitimin do të fillojnë gjatë vitit 2014. Pagesat e rimbursimeve, pas verifikimit, do të kryhen kundrejt fondeve buxhetore të miratuara për këtë qëllim dhe sipas parimit hyrje e parë dalje e parë, duke u bazuar në datën e paraqitjes së kërkesës nga subjekti tatimpagues në organin tatimor (data e protokollit të organit tatimor) pavarësisht se kur është vlerësuar dhe miratuar nga ky i fundit.

Procesi i verifikimit

15. Titullarët e njësive të qeverisjes qendrore sigurohen që të gjitha detyrimet financiare të prapambetura të jenë vlerësuar dhe verifikuar plotësisht përpara dërgimit të dokumentacionit për pagesë. Verifikimet bëhen duke respektuar radhën kohore të lindjes së detyrimit. Dokumentacioni i plotë duhet t'i paraqitet degës së thesarit nga nëpunësit autorizues për kontroll për çdo urdhër pagese, për t'u shqyrtuar më pas nga Komiteti i Detyrimeve të Prapambetura (KDP), siç shpjegohet më poshtë.

16. Detyrimet e lindura në qeverisjen vendore për punimet e papaguara për projektet e infrastrukturës vendore të financuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, do të verifikohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, përpara se nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes vendore të dërgojnë urdhërpagesën me dokumentacionin shoqëruar pranë degës së thesarit.

17. Detyrimet e prapambetura në lidhje me pretendimet e përfitimit për personat me aftësi të kufizuar do të trajtohen pas auditimit të borxhit nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe do të paguhet duke respektuar parimin që detyrimet më të vjetra financiare do të marrin prioritetin më të lartë.

18. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të verifikojë, para se të bëhen pagesat, që pretendimet e rimbursimit të TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin janë të vlefshme. Verifikimi dhe kontrolli do të kryhen bazuar në datën e paraqitjes së kërkesës nga subjekti tatimpagues në organin tatimor (data e protokollit të organit tatimor). Një grup ekspertësh i dedikuar do të ngrihet pranë Ministrisë së Financave për të siguruar minimizimin e riskut të abuzimeve në procesin e rimbursimit të TVSH-së.

19. Përveç kontrolleve të sistemit të thesarit, Kontrolli i Lartë i Shtetit do të verifikojë dokumentacionin mbështetës të një pjese të pretendimeve para pagesës në bazë të parimit të materialitetit



dhe mënyrës së miratuar në memorandumit e nënshkruar midis Ministrisë së Financave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

20. Ministria e Financave mund të kontraktojë një auditor të jashtëm për të verifikuar pretendimet për detyrimet financiare, të cilat nuk janë miratuar për shkak të mospërputhjes së dokumentacionit. Pas verifikimit të këtyre detyrimeve ato përfshihen në listën e detyrimeve financiare për t'u shlyer dhe do t'u nënshtrohen të njëjtave procedura të miratimit dhe pagesës si me detyrimet e raportuara sipas pikës 15 të strategjisë.

Mbikëqyrja e procesit

21. KDP-ja krijohet dhe funksionon në Ministrinë e Financave me përbërjen si vijon:

Zëvendësministri i Financave - kryetar;

Nëpunësi i parë autorizues - anëtar;

Drejtori i Përgjithshëm i Buxhetit - anëtar

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Financiare - anëtar;

Drejtori i Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin - anëtar;

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve - anëtar.

Komiteti do të bëjë aprovimin përfundimtar të listës analitike të detyrimeve të prapambetura për t'u shlyer sipas SPSDP-së. Detyrat e KDP-së jepen në shtojcën 2 të strategjisë. Kontrolli i Lartë i Shtetit do të ketë statusin e vëzhguesit në KDP, duke siguruar që procesi i përshkruar të respektohet për të gjitha pretendimet.

22. Pranë Ministrisë së Financave krijohet një njësi e posaçme teknike, e cila do të mbështesë KDP-në dhe nëpunësin e parë autorizues në menaxhimin e të dhënave të pretendimeve, për të siguruar që pretendimet e verifikuara të paguhen në një mënyrë transparente, të saktë, të besueshme dhe të mbështetura në dokumentacionin e plotë sipas kërkesave ligjore e nënligjore në fuqi. Detyrat e njësisë jepen në shtojcën 3 të strategjisë.

23. KDP-ja do të takohet mesatarisht një herë në dy javë për të shqyrtuar dhe për të miratuar urdhrat e verifikuara të pagesave. Për detyrimet e lindura në pushtetin vendor nëpërmjet mekanizimit të financimit nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, KDP-ja bashkërendon paraprakisht me Sekretariatit e Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, i cili propozon pranë KDP-së masën dhe nivelin e shlyerjes së detyrimeve.

Përgjegjësia e KDP-së do të jetë të sigurojë që kriteret e caktimit të prioritetit për pagesat e specifikuar në strategji të respektohen dhe procesi i verifikimit të jetë i plotë.

24. Menjëherë pasi KDP-ja të aprovohet një kërkesë për pagesë, pagesat do të trajtohen në degën e thesarit ku ushtron veprimtarinë institucionin, i cili është përgjegjës përpara ligjit për shlyerjen e detyrimit të marrë përsipër prej tij.

25. Para pagesës, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve do të verifikojnë që subjektet kontraktore, të cilat paguhen sipas strategjisë, nuk kanë detyrime tatimore kundrejt administratës tatimore qendrore. Në këto raste, subjekti do të njoftohet me shkrim që detyrimi i pashlyer do të paguhet duke marrë në konsideratë detyrimet tatimore të pashlyera dhe do t'i jepet mundësi për t'u shprehur.

26. Një audit ndërkombëtar do të angazhohet nga ministri i Financave për të ndërmarrë një auditim të plotë financiar të një ekzemplari të pagesave të bëra sipas strategjisë së shlyerjes. Objektivi i auditit do të jetë dhënia e një mendimi të pavarur profesional për një model pagesash të audituara, i cili do të përfshijë një mendim për përshtatshmërinë e shpenzimit dhe përputhshmërinë me marrëveshjet përkatëse ligjore dhe strategjinë e shlyerjes. Auditit do të raportojë mbi ekzemplarin e testuar, duke përfshirë çështjet që kanë ardhur në vëmendje të auditit, të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm mbi vlefshmërinë e strategjisë së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura. Konstatimet e auditit për rastet e abuzimit me fondet publike do të rezultojnë në pezullimin e pagesave të tjera sipas strategjisë në pritje të hetimit.

Kryerja e pagesave

27. Pagesat për subjektet kontraktore do të bëhen pas njoftimit zyrtar nga DPT-ja dhe DPD-ja për detyrimet tatimore, si dhe aprovimit të listës analitike nga KDP-ja.

28. Të gjitha pagesat do të kryhen nëpërmjet sistemit të thesarit me transfertë të vlerës totale të detyrimit në llogarinë bankare të subjektit/individit.

29. Në rastet kur subjekti tatimpagues figuron me detyrime tatimore ndaj administratës tatimore qendrore, pagesa do të kryhet nga thesari për totalin e detyrimit financiar të prapambetur duke përdorur një nga mënyrat si më poshtë vijon:

a) Pas dhënies së garancisë bankare për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga ana e subjektit tatimpagues;

b) Transfertë në një llogari bankare *escrow* kundrejt konsensusit për shlyerjen e detyrimeve tatimore, të shprehur me një marrëveshjeje midis Ministrisë së Financave, subjektit tatimpagues dhe Bankës së nivelit të dytë ku ka llogarinë subjekti.

Shlyerja e detyrimeve të prapambetura ndërmjet kompanive në sektorin e energjisë

30. Këshilli i Ministrave miraton një plan të veçantë kohor të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura ndërmjet shoqërive në sektorin e energjisë.

Raportimi financiar

31. Informacioni financiar për pagesat e detyrimeve të prapambetura do të përditësohet çdo muaj dhe do të publikohet në faqen e internetit të MF-së me bazë mujore. Ky raport do të përfshijë gjendjen fillestare të verifikuar në zërat e tabelës 1, pagesat e bëra gjatë periudhës nga çdo institucion buxhetor, llojin e detyrimit financiar, përfituesin dhe balancën e verifikuar mbyllëse të mbetur.

32. Pagesat e bëra sipas kësaj strategjie për kontraktorët tregtarë/individët do të identifikohen (veçmas nga pagesat e rregullta të vitit buxhetor) dhe do të publikohen në faqen e internetit të Ministrisë së Financave me bazë javore për qëllimet e transparencës. Nënkontraktorët dhe bankat e nivelit të dytë mund të përdorin informacionin e mësipërm për t'u siguruar që, shumat e kërkueshme nga kontraktorët kryesorë (nëpërmjet shlyerjeve të huave tregtare ose pagesat për punët e kryera sipas një marrëveshjeje nënkontraktuale), mund të paguhen nga kontraktori primar. Raporti do të përfshijë emrin e kontraktorit, datën origjinale të faturës dhe shumën e paguar.

SHTOJCA 1 PLAN VEPRIMI PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Masat	Aktiviteti	Afatet dhe institucioni përgjegjës
Përfundimi dhe përditësimi i listës së detyrimeve financiare siç figurojnë në llogaritë kontabël të njësive në datën 31 dhjetor 2013	- Përfundimi i inventarizimit dhe rakordimi i të dhënave për kontratat, urdhrat e gjykatës, të formës së prerë, përfitimet nga paaftësia dhe kategoritë e tjera të detyrimeve të prapambetura deri më 31 dhjetor 2013	Të gjitha institucionet, 30 janar 2014
	- Ngritja e një njësie të specializuar për kohëzgjatjen e operacionit të shlyerjes për të mbështetur KDP-në në mbledhjen e të dhënave dhe për t'u ndërlidhur me institucionet	MF, shkurt 2014 MF, mars 2014
	- Krijimi i një baze të dhënash për detyrimet e prapambetura dhe përmbledhja e informacionit për KDP-në. Rakordimi i ndryshimeve të identifikuar me raportin e Deloitte-t	Çdo titullar institucioni
	- Hetimi i pretendimeve të kontraktorëve që nuk janë deklaruar nga ministritë në raportin e Deloitte-t	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
	- Sigurimi që vetëm pretendimet e vlefshme të identifikohen për pagesat e pashlyera të përfitimit nga paaftësia dhe përfshirja e tyre si detyrime të prapambetura	KDP, MF
	- Miratimi/përpilimi i listës së detyrimeve të të rakorduara, të aprovuara për pagesë dhe përditësimi i vazhdueshëm pas shlyerjes	



Miratimi i draftligjit “Për pagesat e vonuara në transaksionet tregtare”	- Hartimi i draftligjit dhe miratimi në KM	Ministria e Ekonomisë Shkurt 2014
Krijimi i Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura me termat e referencës	- Krijimi i Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura për mbikëqyrjen e aktiviteteve sipas planit të veprimit dhe detyrave të përcaktuara në strategji (shtojca 1 dhe 2)	MF, shkurt 2014
Nënshkrimi i memorandumit midis Ministrisë së Financave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit	Nënshkrimi i memorandumit midis Ministrisë së Financave dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit	shkurt 2014
Miratimi i termave të referencës për auditet ndërkombëtarë të jashtëm dhe ndërmarrja e procesit të prokurimit	- Miratimi i termave të referencës, objektit të punës dhe aktiviteteve të auditëve - Fillimi i procesit të prokurimit	MF / BE
Rakordimi me Kontrollin e Lartë të Shtetit i kërkesave për përfshirjen e auditit në verifikimin paraprak të pagesave	- Miratimi i termave të referencës për shpalljen. - Miratimi i kriterëve të punës për auditet (koha, cilësia) - Kontraktimi i auditëve	KLSH
Zbatimi i masave parandaluese	- Zhvillimi i një baze të dhënash për regjistrimin e urdhrave të prokurimit (në konsultim me Agjencinë e Prokurimeve Publike) - Hartimi i udhëzimit për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe përcaktimi i formatit për raportimin e detyrimeve të prapambetura nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme - Përgatitja e ndryshimeve në kuadrin ligjor - Rikonfigurimi i SIFQ (prokurimi i ekspertizës teknike dhe zbatimi i ndryshimeve në sistem) për kontrollin e faturave dhe kontrollin e kontratave shumëvjeçare	Institucionet, APP, MF MF, shkurt 2014 MF, shtator 2014 30 qershor 2014

SHTOJCA 2 DETYRAT E KOMITETIT TË DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA

Objektivat

Qëllimi i Komitetit është mbikëqyrja e zbatimit të strategjisë së parandalimit dhe shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në emër të Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Ministrave. Kjo do të sigurojë që detyrimet e prapambetura të paguhen në mënyrë të plotë, transparente, brenda një afati realist kohor dhe që të gjitha pretendimet të verifikohen. Komiteti do t'i raportojë direkt ministrit të Financave.

Përbërja

Komiteti i Detyrimeve të Prapambetura (KDP) do të përfshijë, ndërmjet të tjerash, zëvendësministrin e Financave (kryetari), nëpunësin e parë autorizues, Drejtorin e Përgjithshëm të Buxhetit, Drejtorin e Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve (për të vlerësuar detyrimet tatimore të subjekteve) dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimeve Financiare. Anëtarë të tjerë do të thirren sipas rastit. Kryetar i Komitetit do të bëjë aprovimin përfundimtar për pagesat. Kontrolli i Lartë i Shtetit do të jetë i pranishëm si vëzhgues.

Komiteti do të mbështetet nga një njësi speciale me detyrë, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave për pretendimet dhe paraqitjen e raporteve dhe dokumentacionit të KDP-ja.

Detyrat e Komitetit

KDP-ja do të mblidhet një herë në dy javë për ushtrimin e funksioneve të veta si vijon:

1. Sigurohet që është përgatitur një bazë e plotë të dhënash për detyrimet e prapambetura, siç figurojnë në datën 31 dhjetor 2013 dhe që të gjitha pagesat e përfshira në bazën e të dhënave përfshihen në përkufizimin e detyrimeve të prapambetura.

2. Monitoron dhe i raporton ministrit të Financave për zbatimin e planit të veprimit të strategjisë (shtojca 1).
3. Merr raporte monitorimi nga nëpunësit autorizues dhe të sigurohet që pagesat kryhen sipas prioriteteve për pagesat të përcaktuara në strategjinë e shlyerjes dhe parandalimit.
4. Merr raporte/opinion nga thesari për cilësinë e dokumentacionit të dërguar nga nëpunësit autorizues.
5. Merr në konsideratë raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për verifikimin e plotësisë së dokumentacionit të pagesave para miratimit të tyre sipas memorandumit midis MF-së dhe KLSH-së.
6. Komiteti kërkon praninë e nëpunësve autorizues të ministrive të linjës në rastin e mosparaqitjes së të dhënave të përshtatshme mbështetëse.
7. Jep miratimin përfundimtar për listën analitike të detyrimeve të prapambetura që duhet të procesohen nga institucionet dhe sistemi i thesarit sipas strategjisë.
8. Monitoron zbatimin dhe efektivitetin e masave të parandalimit nëpërmjet raporteve periodike përmbledhëse nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore lidhur me angazhimet e reja gjatë vitit 2014.
9. Vë në dispozicion të auditit ndërkombëtar dokumentacionin e plotë ku bazohen pagesat e kryera.
10. Harton komentet formale për raportet e auditit ndërkombëtar dhe ndalon pagesat nëse ka dyshim në lidhje me legjitimitetin e pretendimit.
11. Çdo detyrë tjetër në lidhje me menaxhimin e procesit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura sipas kërkesës së ministrit të Financave.

SHTOJCA 3 DETYRAT E NJËSISË SË POSAÇME PRANË MINISTRISË SË FINANCAVE

Në Ministrinë e Financave do të ngrihet një njësi e posaçme për të mbështetur KDP-në, për të siguruar që të dhënat mbi detyrimet e prapambetura menaxhohen me efektivitet dhe që Komiteti të mbështetet mbi bazë ditore. Njësia mbështetëse e KDP-së kryen detyrat e mëposhtme:

1. Harton dokumentin për detajimin e fondeve buxhetore sipas kategorive të detyrimeve financiare dhe institucioneve, si dhe harton modelet e raportimit sipas strategjisë së shlyerjes dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura;
2. Përpunon dhe liston raportet e hartuara nga ministritë dhe institucionet qendrore mbi detyrimet e prapambetura, që do të përfshihen në strategjinë e shlyerjes, sipas kategorive dhe momentit kohor të krijimit të tyre (metoda hyrje e parë - dalje e parë).
3. Krijon, përditëson dhe ruan bazën e të dhënave për detyrimet e prapambetura, si dhe bashkërendon punën për buxhetimin e tyre si në vitin aktual ashtu edhe në vitet në vazhdim.
4. Në rast paraqitje të dokumentacionit të paplotësuar kryen ndjekjen e procesit direkt tek institucionet përgjegjëse deri në plotësimin e dokumentacionit.
5. Prezanton problematikat gjatë monitorimit të pagesave për t'u shqyrtuar nga KDP-ja, të shoqëruara me propozimet për zgjidhjen e tyre.
6. Kryen rolin e Sekretariatit të KDP-së dhe publikon vendimet e KDP-së.
7. Siguron publikimin e raporteve mbi bazë javore lidhur me pagesat e kryera, dhe mbi bazë mujore për fondet buxhetore të alokuara, pagesat e bëra gjatë muajit, detyrimet e pranuar për pagesë dhe balancën përfundimtare.
8. Siguron KDP-në që: i) secila pagesë është plotësisht e dokumentuar; ii) për të gjitha pagesat e kryera është marrë në konsideratë masa e detyrimeve tatimore që ka secili subjekt përfitues ndaj administratës tatimore qendrore; iii) si dhe evidentimi i tyre është bërë mbi bazë bruto sipas rregullimeve të kontabilitetit publik.
9. Mban kontaktet me auditin ndërkombëtar dhe KLSH-në dhe ofron dokumentacionin e kërkuar. Jep arsytet para KDP-së për dokumentacionin e munguar.
10. Monitoron procesin e parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura pas 1 janarit 2014, duke zhvilluar sondazhe semestrale te ministritë kryesore të linjës për të gjitha kontratat e



investimeve, kontratat e mallrave dhe të shërbimeve me vlerë mbi 30 milionë lekë, si dhe ekzistencën e faturave të pashlyera nga muaji janar 2014.

VENDIM
Nr. 54, datë 5.2.2014

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURËS E TË MËNYRËS SË DHËNIES ME QIRA, ENFITEOZË APO KONTRATA TË TJERA TË PASURISË SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, dhe të neneve 784 e 801 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PASURITË SHTETËRORE QË JEPEN ME QIRA OSE ENFITEOZË, KRITERET E KONKURRIMIT, E DREJTA, KOMPETENCAT DHE AFATET

1. Pasuritë shtetërore u jepen të tretëve, duke u transferuar të drejtën e përdorimit me qira ose enfiteozë, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

2. Pasuritë shtetërore, që jepen me qira, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi, janë: ndërtesat, sipërfaqet funksionale (jo nën ndërtesë), trualli i lirë, makineritë e pajisjet e linjat e prodhimit të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare me kapital 100 për qind shtetëror (në vijim “shoqëri shtetërore”). Pasuritë shtetërore, që jepen me enfiteozë sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi, janë vetëm pasuritë e paluajtshme të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve dhe shoqërive shtetërore.

3. Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira të pasurisë shtetërore janë si më poshtë vijon:

- niveli i investimit;
- niveli i punësimit;
- oferta e detyrimit mujor të qirasë.

Institucionet qendrore dhe vendore mund të vendosin edhe kritere të tjera shtesë.

4. Kriteret e konkurrimit për dhënien me enfiteozë të pasurisë shtetërore janë si më poshtë vijon:

- niveli i investimit në pasuri të paluajtshme për përmirësimin e pronës, i cili të jetë mbi 200 për qind të vlerës së pasurisë së shpallur për konkurrim;

- qëllimi dhe niveli i investimit në tërësi në pasurinë që jepet me enfiteozë;

- niveli i punësimit;

- oferta e detyrimit mujor.

Institucionet qendrore dhe vendore mund të vendosin edhe kritere të tjera shtesë.

5. Përjashtohen nga konkurrimi:

a) dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m², të cilat jepen me afat deri në 1 vit;

b) makineritë e pajisjet e shkëputura, të cilat jepen me afat deri në 1 vit;

c) dhënia me qira e pasurive shtetërore, subjekteve të pajisura me leje shfrytëzimi të pasurive natyrore minerare, peshkimit, ujërave e të veprimtarive të tjera, të ngjashme, kur këto pasuri i jepen subjektit, në ndihmë të zhvillimit të aktivitetit, për të cilin është licencuar;

ç) rastet kur me ligj janë miratuar marrëveshje minerare të shfrytëzimit, subjekti i licencuar ka të drejtën e lidhjes së kontratës së huapërdorjes për sipërfaqen e ndërtimit të fabrikave (sipërfaqe kjo e konfirmuar nga plani i biznesit, i paraqitur për marrjen e lejes së shfrytëzimit), me të drejtë përsëritjeje deri në përfundim të periudhës së licencimit;

d) dhënia me qira e objekteve shtetërore për institucionet shtetërore, kur ato do të përdoren për nevoja dhe aktivitete të mëtejshme shtetërore;

dh) dhënia me qira e pasurive shtetërore, subjekteve shtetërore ose private për ushtrimin e aktiviteteve në fushën e sportit, kulturës, turizmit dhe trashëgimisë kulturore, kundrejt investimeve në pasurinë shtetërore të vlerave mbi 2 (dy) milionë euro;

e) shtesat në kontratë për sipërfaqet funksionale që kërkohen nga qiramarrësi për të shtuar ose për të përmirësuar veprimtarinë, për sipërfaqe jo më shumë se 50% e sipërfaqes totale të truallit ku shtrihet objekti i marrë me qira dhe vetëm në rastet kur sipërfaqja shtesë shtrihet në kufi me sipërfaqen e kontratës.

6. Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë:

a) institucioni shtetëror, ndërmarrja ose shoqëria shtetërore, që jep me qira, për një afat deri në 1 (një) vit:

i) objekte që ka në administrim, me sipërfaqe deri në 200 m² (ku të jetë përfshirë dhe sipërfaqja funksionale);

ii) objektet voluminoze, si: depozita, silose etj., me vëllim deri në 300 m³, makineri, pajisje, linja teknologjike, të shkëputura, që janë të instaluar brenda këtyre sipërfaqeve.

Institucionet, ndërmarrjet a shoqëritë shtetërore nuk mund të japin me qira vetëm “truall të lirë” me sipërfaqe deri në 200 m².

b) organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, që jep me qira deri në 20 vjet:

i) sipërfaqe mbi 200 m²;

ii) linjat teknologjike apo objektet voluminoze, si depozita e silose me volum mbi 300 m³, që janë të instaluar brenda këtyre sipërfaqeve.

Afati i lidhjes së kontratës për sipërfaqet 200 - 500 m² është deri në 10 (dhjetë) vjet, ndërsa për sipërfaqet mbi 500 m² është deri në 20 (njëzet) vjet.

7. Të drejtën e lidhjes së kontratës së enfiteozës për pasuritë shtetërore, me afat deri në 20 (njëzet) vjet, e ka ministria përgjegjëse për ekonominë ose organi i qeverisjes vendore, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit mbi pronën.

8. Pasuritë në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare jepen me qira prej saj, me afat deri në një vit, pa kufizim për sipërfaqen e tyre, sipas tarifave të përcaktuara në aneksin “B”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Pasuritë në administrim të Autoritetit Portual Durrës jepen me qira ose enfiteozë prej tij, në përputhje me ligjin nr. 9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual”, sipas procedurave të këtij vendimi.

10. Monumentet e kulturës jepen me qira ose enfiteozë nga Ministria e Kulturës në përputhje me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar.

11. Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë me subjektet e pajisura me leje shfrytëzimi të pasurive natyrore-minerare, peshkimit, ujërave, veprimtarive të tjera të ngjashme, e ka institucioni qendror shtetëror që mbulon veprimtarinë përkatëse, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative.

II. PROCEDURAT E DHËNIES ME QIRA OSE ENFITEOZË TË PASURISË SHTETËRORE

1. Institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore, që ka në administrim objektin që do të jepet me qira ose enfiteozë, për të gjitha rastet, përgatit dokumentacionin si më poshtë vijon:

a) propozimin për dhënie me qira ose enfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri dhe afatin e dhënies me qira;

b) vendimin e organit drejtues të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore (Këshilli Mbikëqyrës, Këshilli Drejtues, Bordi Drejtues etj.);

c) miratimin e organit të varësisë administrative;

ç) genplanin e objektit në 6 (gjashtë) kopje origjinale, të konfirmuar nga drejtuesi i institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore dhe nga organi i prefekturës, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, ku të jenë përcaktuar qartë sipërfaqja e truallit gjithsej, sipërfaqja e truallit nën ndërtesë dhe sipërfaqja funksionale (jo nën ndërtesë);



d) tarifën dysHEME të detyrimit mujor për sipërfaqet nën ndërtesë, sipas përcaktimeve në këtë vendim dhe duke pasur parasysh edhe gjendjen fizike të objektit;

dh) konfirmimin nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për pronësinë shtet të objektit dhe truallit, si dhe nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për vendimet që mund të ketë dhënë për njohje ose kthim prone. Në rastet kur pasuria, që jepet me qira ose enfiteozë, është në administrim të shoqërive shtetërore, nuk është e nevojshme të kërkohet konfirmimi nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

2. Në rastet e propozimit për dhënien me enfiteozë të objektit, përveç dokumentacionit të sipërpërmendur duhet të specifikohet edhe vlera kontabël e pasurisë, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës.

3. Për pasuritë e përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 6 të kreut I të këtij vendimi, institucioni shtetëror a shoqëria shtetërore, pas përgatitjes së dokumentacionit sipas pikës 1 të këtij kreu, lidh kontratën e qirasë.

4. Për objektet e përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 6 të kreut I të këtij vendimi, pas përgatitjes së dokumentacionit, drejtuesi i institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, që ka në administrim pasurinë që do të jepet me qira ose enfiteozë, e përcjell atë në organin që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, i cili, me urdhër të titullarit të tij, fillon procedurat për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore.

5. Në urdhrin e titullarit të institucionit për dhënien me qira ose enfiteozë, me konkurrim, të pasurisë shtetërore përcaktohen:

a) të dhënat për pasurinë shtetërore që jepet me qira apo enfiteozë: emërtimi, sipërfaqja, qëllimi i përdorimit, vlera dysHEME e detyrimit mujor të llogaritur sipas tarifave të këtij vendimi e afati;

b) veprimtaria që mund të ushtrohet në objekt;

c) pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, sipas pikave 3 ose 4 të kreut I të këtij vendimi, të cilat caktohen, rast pas rasti, nga titullari i institucionit;

ç) vendi, data dhe ora, ku paraqiten dokumentet;

d) përbërja e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve, me tri veta, një kryetar e dy anëtarë;

dh) dokumentacioni që paraqitet nga konkurrentët për konkurrim.

6. Njoftimi për publikim për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore shpallet 1 (një) herë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në njoftim përcaktohen të dhënat për objektin, kategorizimin e veprimtarisë që do të ushtrohet në objekt, afati i dhënies me qira ose enfiteozë, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, dokumentacioni që do të paraqesin konkurrentët, si dhe vendi, data dhe ora e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e botimit të fundit.

7. Dokumentacioni për marrjen me qira, që paraqesin konkurrentët, i dorëzohet komisionit në orën e hapjes së konkurrimit dhe përmban:

a) kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;

b) planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen;

c) ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;

ç) certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR;

d) NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;

dh) vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

Ky dokumentacion duhet të plotësohet edhe në rastet kur objekti jepet me qira pa konkurrim.

8. Dokumentacioni për marrjen me enfiteozë, që paraqesin konkurrentët, të cilët duhet të jenë shoqëri tregtare, i dorëzohet komisionit dhe përmban:

a) kërkesën e subjektit për marrje me enfiteozë të pasurisë shtetërore;

b) planbiznesin e hollësishëm për përmirësimin e pronës;

c) përshkrimin e projektideve të investimit, të dhëna për nivelin e investimeve të parashikuara në pasuri të paluajtshme dhe në objektin në tërësi, shoqëruar me projekte, skica dhe dokumentacion tjetër paraprak, si dhe burimin e financimit të projektit;

ç) ofertën për vlerën e detyrimit mujor;

d) CV-në e subjektit, ku të tregohet përvoja në fushën e aktivitetit ekonomik që do të ushtrohet në pasurinë që jepet me enfiteozë, të shoqëruar me dokumentacion vërtetues;

dh) certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR;

e) NIPT-in e subjektit;

ë) vërtetimin nga dega e tatimeve, që subjekti ka shlyer ose nuk ka detyrime tatimore;

f) vërtetimin nga dega e doganës se ka zhvilluar eksport apo kontrata eksportuese efektive, në rastet kur subjektet kryejnë veprimtari eksportuese.

9. Komisioni i dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore kryen këto detyra:

a) merr në dorëzim zarfet e mbyllura të konkurrentëve pjesëmarrës dhe i hap në prani të tyre, i lexon dhe u bën të njohur të dhënat kryesore të dokumenteve dhe treguesve konkurrues, për çdo ofertë të paraqitur. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, konkurrenti nuk kualifikohet në prani të tij;

b) harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruan pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe shkakun, konkurrentët e kualifikuar dhe listën e dokumenteve të paraqitura prej tyre;

c) brenda 10 (dhjetë) ditëve bën shqyrtimin e ofertave të paraqitura dhe vlerëson me pikë çdo element konkurrimi, sipas përcaktimit në urdhrin e titullarit. Subjektit, që paraqet vlerën më të lartë të propozuar, i jepen pikët maksimale të çdo elementi konkurrimi, ndërsa subjekteve të tjera pikët u llogariten në përpjesëtim të drejtë me vlerën më të lartë, të propozuar. Në përfundim, konkurruesit renditen në bazë të shumës së pikëve të përfituara;

ç) paraqet brenda afatit të përcaktuar në shkronjën “c” të kësaj pike, te titullari i institucionit shtetëror, që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë ose të enfiteozës, informacion për zhvillimin e konkurrimit, së bashku me procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit dhe listën e konkurruesve, të renditur sipas pikëve të fituara.

10. Titullari i institucionit, që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë ose të enfiteozës, vendos për subjektin fitues në konkurrim. Kur në konkurrim marrin pjesë më shumë se një konkurrues, njoftimi për shpalljen e fituesit vendoset në këndin e njoftimeve të institucionit përkatës.

11. Subjektet konkurruese, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimit te titullari i institucionit, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, i kthen përgjigje me shkrim ankuesit.

12. Pas përfundimit të procedurave të sipërpërmendura, fillojnë procedurat për hartimin dhe lidhjen e kontratës së qirasë ose të enfiteozës.

13. Kur subjekti fitues tërhiqet, procedurat e lidhjes së kontratës vazhdojnë me subjektin e klasifikuar në vend të dytë.

14. Para nënshkrimit të kontratës së qirasë ose të enfiteozës, qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi është i detyruar të kryejë pagesën e garancisë së kontratës, e cila është e barabartë me vlerën e tre muajve të pagesës së qirasë ose të enfiteozës. Garancia ngurtësohet deri në fund të kontratës dhe i kthehet qiramarrësit ose enfiteozëmarrësit me përfundimin e kontratës.

III. TARIFAT DHE VLERA DYSHEME PËR PASURITË SHTETËRORE QË JEPEN ME QIRA OSE ENFITEOZË

1. Për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, vlera dysHEME e detyrimit mujor përcaktohet si shumë e vlerës së qirasë mujore për ndërtesën dhe sipërfaqen funksionale që jepet me qira ose enfiteozë, të llogaritura si më poshtë vijon:

a) për ndërtesat (quhen të tilla sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore në fuqi në fushën e planifikimit të territorit), tarifaf dysHEME të qirasë mujore janë sipas tarifave të përcaktuara në aneksin “A” bashkëlidhur këtij vendimi;

b) për sipërfaqen funksionale, tarifa dysHEME e qirasë mujore është 20 për qind e tarifës dysHEME të detyrimit mujor, të përcaktuar për ndërtesat. Trualli nën ndërtesë (objekti) përfshihet në tarifën e qirasë së ndërtesës.



2. Kur jepet me qira truall i lirë, pra kur jepet me qira ose enfiteozë vetëm truall, tarifa dysHEME e qirasë mujore është 100 lekë/m².

3. Për pasuritë e institucioneve shtetërore apo të shoqërive shtetërore me karakter kombëtar (kulturor, historik, muzeor, arkeologjik), të shpallura të tilla me akte ligjore, tarifa dysHEME e detyrimit mujor, e përcaktuar më sipër, shumëzohet me 2 (dy).

4. Kur ndërtesa është me dy ose më shumë kate, për efekt të llogaritjes së qirasë mujore do të merret parasysh sipërfaqja e çdo kati.

5. Për përcaktimin e vlerës së detyrimit mujor të qirasë, për pasuritë e luajtshme (makineritë, pajisjet, linjat teknologjike, makineritë e pajisjet në galeritë minerare etj.), që jepen me qira, institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore që ka në administrim pasurinë, përcakton vlerën e qirasë vjetore, që është sa 1/10 e VAM-it (vlerës aktuale minimale), të llogaritur si diferencë e vlerës fillestare të kontabilizuar minus amortizimin në vite, mbështetur në vendimin nr. 401, datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave (pjesa për investime), shumëzuar me indeksin e çmimeve të muajit përkatës, të publikuar nga INSTAT-i.

6. Për objektet voluminoze, si: rezervuarët, depozitat dhe siloset, që jepen me qira me qëllim tregtimi brenda vijave kufizuese të qyteteve: Tiranë, Berat, Durrës, Fier, Korçë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Gjirokastër, Kavajë, Krujë, Laç, Lezhë, tarifa dysHEME e qirasë është 400 lekë/m³ në muaj, ndërsa jashtë vijave kufizuese të qyteteve të sipërpërmendura, si dhe në të gjitha zonat e tjera tarifa e qirasë është 200 lekë/m³ në muaj.

7. Për terrenet sportive, përcaktuar si të tilla me akte ligjore dhe kur do të kryhet aktivitet sportiv, tarifa dysHEME e qirasë mujore është 10 lekë/m² në muaj.

8. Për pasuritë në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, tarifet minimale të detyrimit mujor të qirasë të jenë sipas tabelës "B", që i bashkëlidhet këtij vendimi. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për mjediset e Pallatit të Kongreseve, në raste të veçanta, aplikon tarifa të ndryshme me ato të parashikuara më lart, me miratim të Këshillit të Ministrave.

IV. NXITJA E BIZNESIT

1. Për objektet e dhëna me qira ose enfiteozë, me sipërfaqe mbi 200 m², vlera e detyrimit mujor rillogaritet me zbritje, kur subjekti që ka marrë me qira ose enfiteozë, vërteton në llogaritë financiare vjetore të tij se ka kryer investime në pasurinë e marrë me qira ose enfiteozë për përmirësimin e saj, si dhe për blerje e instalim linjash, makinerish e pajisjesh në vlerat, si më poshtë vijon:

- investime mbi 50 milionë lekë, zbritja është 10%;
- investime mbi 80 milionë lekë, zbritja është 20%;
- investime mbi 100 milionë lekë, zbritja është 30%;
- investime mbi 150 milionë lekë, zbritja është 40%.

2. Ulja e vlerës së detyrimit mujor nga realizimi i investimeve vlen deri në përfundimin e afatit të kontratës së qirasë apo të enfiteozës.

V. KONTRATA ME TARIFËN SIMBOLIKE 1 EURO KONTRATA

1. Pasuritë shtetërore, me sipërfaqe mbi 500 m², u jepen të tretëve edhe me kontrata qiraje, me tarifë simbolike 1 (një) euro/kontrata, me vendim, rast pas rasti, të Këshillit të Ministrave.

2. Kur, pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, rezulton fitues një subjekt, i cili propozon që në pasurinë shtetërore që jepet me qira do të zhvillohen aktivitetet, si:

- a) veprimtari prodhuese industriale në nivele investimi mbi 10 milionë euro;
- b) veprimtari prodhuese të regjimit "Fason",

atëherë, në këtë rast, institucioni që zhvillon procedurën dhe që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit shtet për pasurinë, i propozon Këshillit të Ministrave lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën simbolike 1 (një) euro/kontrata.

3. Ministria përgjegjëse për ekonominë mund të propozojë në Këshillin e Ministrave dhënien me qira të pasurisë shtetërore, pa konkurrim dhe me tarifë simbolike 1 (një) euro/kontrata, kur me ofertë "të pakërkuar", ka propozim për kryerjen e investimeve në vlera mbi 2 milionë euro për zhvillimin e zonave të veçanta, duke kryer këto aktivitete:

- a) veprimtari në fushën e sportit, kulturës, turizmit dhe trashëgimisë kulturore;

b) veprimtari që do të ndikojnë në zgjidhjen e problemeve sociale në zona të veçanta.

4. Para nënshkrimit të kontratës së qirasë, me tarifë 1 euro/kontrata, qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi është i detyruar të kryejë pagesën e garancisë së kontratës, në vlerën 10 për qind të vlerës së investimit të marrë përsipër në konkurrim. Garancia kthehet pas përfundimit të investimit.

5. Në rast se subjekti, që ka lidhur një kontratë me tarifë 1 euro/kontrata, nuk realizon kushtet e saj, kontrata kthehet në kontratë qiraje ose enfiteoze, dhe vlera e detyrimit mujor rillogaritet, sipas tarifave të përcaktuara në kreun III të këtij vendimi, si dhe merr gjobë në masën e garancisë së depozituar në çastin e lidhjes së kontratës.

6. Kontratat e qirasë, të lidhura para daljes së këtij vendimi, ku realizohet veprimtari prodhuese me regjim “Fason”, kthehen në kontrata me tarifë simbolike 1 (një) euro/kontrata, pas daljes së këtij vendimi, duke ruajtur si garanci kontrate atë të kontratës së qirasë. Specifikimet për rastet dhe procedurat për ndryshimin e këtyre kontratave bëhen me udhëzim të ministrit përgjegjës për ekonominë.

7. Pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, për dhënien me qira të pasurisë shtetërore me tarifë simbolike 1 (një) euro/kontrata, ministria përgjegjëse për ekonominë fillon procedurat, që janë të njëjta me ato të përcaktuara në kreun II të këtij vendimi.

VI. MONITORIMI I KONTRATAVE

1. Monitorimi i kontratave të qirasë dhe të enfiteozës drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës. Monitorimi bëhet nga njësitë monitoruese që janë institucionet shtetërore, shoqëritë tregtare dhe ish-ndërmarrjet shtetërore që kanë në administrim objektet e dhëna me qira ose enfiteozë, si dhe nga degët e shoqërive publike pranë prefekturave.

2. Njësia monitoruese e kontratave të qirasë ose të enfiteozës kryen këto detyra:

a) Pas lidhjes së kontratës së qirasë ose të enfiteozës, bën dorëzimin të qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës. Në procesverbal përshkruhen qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose enfiteozë, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës dhe shoqërohet me pamje fotografike të momentit.

b) Kur mbaron afati i kontratës ose kur kontrata zgjidhet para afatit, merr në dorëzim me procesverbal objektin që ka në administrim.

c) Ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë ose të enfiteozës dhe çdo 6 (gjashtë) muaj harton akte rakordimi me subjektet qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse.

ç) Dërgon në degën e shoqërive publike, pranë prefekturës, një kopje të kontratave të lidhura sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 6 të kreut I, shoqëruar me kopje të genplanit të objektit të dhënë me qira.

d) Për çdo kontratë të lidhur, në fund të 6-mujorit të parë, brenda datës 15 korrik, dhe në fund të vitit, brenda datës 20 janar, njësia monitoruese dërgon në degën e shoqërive publike, pranë prefekturës përkatëse, një raport të hollësishëm për ecurinë e tyre, të konfirmuar për arkëtimet dhe nga degët e thesarit të rrethit përkatës.

dh) Për çdo ndryshim në dhëniet me qira dhe enfiteozë apo lirim nga këto të drejta, hap pas hapi, kjo njësi njofton për ndryshimet menjëherë degën e shoqërive publike pranë prefekturës përkatëse, e cila bën ndryshimet në regjistrin e krijuar.

e) Për kontratat e lidhura sipas shkronjës “b” të pikës 6 të kreut I të këtij vendimi, çdo tre muaj dërgon në organin që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës, raportin përkatës për realizimin e derdhjes së detyrimeve të qirasë mujore dhe treguesve të tjerë të kontratës, shoqëruar me dokumentin e derdhjes dhe çdo dokumentacion tjetër të vlefshëm.

3. Degët e shoqërive publike pranë prefekturave, për monitorimin e kontratave të qirasë dhe të enfiteozës, kryejnë këto detyra:

a) Pasi kanë marrë të dhënat nga njësitë monitoruese të kontratave të qirasë dhe të enfiteozës, sipas pikës 2 të këtij kreu, krijojnë regjistrin për përdorim nga të tretët të pronës publike dhe të dhënat për të ardhurat nga përdorimi i pronës publike.



b) Mbi bazën e të dhënave të regjistrit bëjnë përmbledhësen si prefekturë, brenda muajit korrik, për të dhënat e 6-mujorit të parë, dhe, brenda muajit janar të vitit pasardhës, për përmbledhësen vjetore, dhe e dërgojnë në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

Ministria përgjegjëse për ekonominë bën përmbledhësen në rang vendi dhe një kopje të saj ia dërgon Ministrisë së Financave, brenda muajit gusht, përmbledhësen 6-mujore, dhe, brenda muajit shkurt, përmbledhësen vjetore.

c) Për kontratat e qirasë të lidhura sipas shkronjës “a” të pikës 6 të kreut I të këtij vendimi, pasi kanë marrë të dhënat nga njësitë administrative, kanë të drejtë të ndërhyjnë në rastet kur vërehen parregullsi në hartimin e kontratës.

4. Titullari i institucionit, që ka lidhur kontratën e qirasë, ka të drejtën e rishikimit ose të faljes së gjobave të shprehura në kontratë, për subjektet, që, për arsye të përligjura, nuk kanë mundur të zbatojnë detyrimet kundrejt kontratës pas kërkesës së “qiramarrësit”.

5. Në rastet kur kontrata është lidhur me persona fizikë dhe nga ana e tyre është marrë përsipër ose janë kryer investime në nivele që në bazë të legjislacionit duhet të ushtrojnë veprimtari si persona juridikë, organi që ka lidhur kontratën bën ndryshimin përkatës në kontratë.

6. Në rastet kur i njëjti subjekt “qiramarrës”, që disponon dy a më shumë kontrata qiraje për sipërfaqe mbi 500 m², me të njëjtin objekt veprimtarie dhe gjeografikisht në kufi me njëra-tjetrën, kërkon bashkimin e kontratave, organi që ka lidhur kontratën bën bashkimin e tyre në një të vetme, duke ruajtur vlerën e qirasë, vlerën e investimit, numrin e të punësuarve dhe të gjitha detyrimet e kontratave që bashkohen. Si datë e mbarimit të kontratës së re të bashkuar do të merret data e kontratës së parë.

Në rastet kur subjektet qiramarrëse, që disponojnë kontrata qiraje me sipërfaqe mbi 5000 m², kërkojnë ndarjen e kontratës në kontrata më të vogla, për shkak të shtesës së aktivitetit ose për një menaxhim më të mirë të investimeve dhe shtesë të tyre në pasurinë e marrë me qira, argumentuar me planbizneset përkatëse, organi që ka lidhur kontratën bën ndarjen e saj në dy pjesë, por jo në sipërfaqe më të vogël se 1000 m².

VII. SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE

1. Të ardhurat, që krijohen nga kontrata e qirave të lidhura për pasuri me sipërfaqe deri me 200 m², ndahen si më poshtë vijon:

- 30 për qind, buxheti i shtetit;
- 70 për qind, ndërmarrja ose shoqëria shtetërore që ka në administrim objektin e dhënë me qira.

2. Të ardhurat, që krijohen nga kontratat e qirave të lidhura në ndërmarrjet dhe shoqëritë shtetërore, ku pushteti vendor është në cilësinë e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, ndahen si më poshtë vijon:

- 50 për qind, organi i pushtetit vendor që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore;

- 50 për qind, ndërmarrja ose shoqëria shtetërore që ka në administrim objektin e dhënë me qira.

3. Të ardhurat, që krijohen nga kontratat e qirasë të lidhura në ndërmarrjet dhe shoqëritë shtetërore me kapital 100 për qind shtetëror, ku ministria përgjegjëse për ekonominë ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, ndahen si më poshtë vijon:

- 30 për qind, ministria përgjegjëse për ekonominë që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, të cilat i përdor për mbulimin e shpenzimeve të shoqërive me kapital 100 për qind shtetëror, që rezultojnë me vështirësi financiare;

- 70 për qind, ndërmarrja dhe shoqëria shtetërore që administrojnë objektin e dhënë me qira.

4. Të ardhurat, që krijohen nga dhënia me qira ose enfiteozë e objekteve me karakter kombëtar (kulturor, historik, muzeor, arkeologjik), ndahen si më poshtë vijon:

- 10 për qind, buxheti i shtetit;
- 90 për qind, institucioni shtetëror që ka në administrim objektin e dhënë me qira.

5. Të ardhurat, që krijohen nga dhënia me qira e pasurive të universiteteve dhe shkollave të larta, në mbështetje të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndahen si më poshtë vijon:

- 10 për qind, buxheti i shtetit;

- 90 për qind, institucioni.

6. Të ardhurat, që krijohen nga dhënia me qira ose enfiteozë e pasurive në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Autoritetit Portual, Durrës, të përdoren prej tyre për të mbuluar shpenzimet e veta.

7. Të ardhurat, që krijohen nga dhënia me qira ose enfiteozë e pasurive në institucionet shtetërore, derdhen në buxhetin e shtetit.

8. Ndërmarrjet dhe shoqëritë shtetërore, pasi derdhen në buxhet, sipas përcaktimeve të mësipërme, të ardhurat që krijohen nga dhënia me qira ose enfiteozë e pasurive në administrim të tyre, pjesën tjetër e përdorin:

- për të mbuluar shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore;
- për investime, vetëm me miratimin e ministrit përgjegjës për ekonominë.

VIII. VLEFSHMËRIA E KONTRATAVE

1. Kontratat e qirasë ose të enfiteozës janë të vlefshme deri në përfundim të afatit të tyre. Kur institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore, që ka dhënë mjedise me qira ose enfiteozë me sipërfaqe mbi 500 m², shitet para përfundimit të afatit të kontratës, në publikimin për shitjen e tyre njoftohet ekzistenca e kontratave të qirasë ose të enfiteozës të lidhura në këtë objekt, si dhe vlera e investimit të kryer nga subjekti që ka marrë me qira ose enfiteozë. Blerësi është i detyruar të respektojë kushtet e kontratës deri në përfundim të afatit të saj.

2. Në rastet kur në kontratë është parashikuar zgjidhja e kontratës së qirasë ose të enfiteozës, kur pasuria shtetërore kalon në procedurë privatizimi, kontrata e qirasë zgjidhjet automatikisht në datën kur enti shitës autorizon shitjen e pasurisë.

3. Për truallin e dhënë në përdorim të tretëve në bazë të një kontrate qiraje ose enfiteoze, të njohur dhe të kthyer pronarit në zbatim të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, kur ndërtesa në pronësi të pronarit shtet nuk përdoret për interes publik, shteti detyrohet t’i paguajë subjektit të shpronësuar qiranë e truallit të përfshirë në kontratën e qirasë apo të enfiteozës, për të cilën ai është njohur pronar, sipas vlerës së përcaktuar në kontratën e lidhur.

Vlera e qirasë së truallit që i kalon pronarit do të jetë shuma e vlerës së qirasë së truallit të lirë funksional, me vlerën e qirasë së truallit nën ndërtesë. Qiraja për m² e truallit funksional do të jetë sipas tarifës së aplikuar në kontratë. Qiraja për m² e truallit nën ndërtesë, e cila në kontratë përfshihet në tarifën e qirasë së ndërtesës, do të llogaritet 20 për qind e tarifës së qirasë për ndërtesën e përcaktuar në kontratë.

Kërkesa depozitohet pranë organit që ka në administrim pronën shtetërore të dhënë me qira ose enfiteozë, i cili bën konfirmimin e sipërfaqes së kthyer sipas vendimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe sipërfaqes përkatëse të dhënë me qira ose enfiteozë, nëpërmjet mbivendosijes së tyre. Me plotësimin e kësaj procedure, ky organ e dërgon praktikën tek organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës, për lidhjen e marrëveshjes me pronarët për dhënien e qirasë së truallit.

Kjo procedurë nuk zbatohet kur prona është pjesë e kapitalit të shoqërive tregtare shtetërore.

Vlera e qirasë së truallit i kalon pronarit, sipas procedurave të mësipërme, kur investimi i kryer nga subjekti, që ka marrë me qira apo enfiteozë, është nën 150 për qind të vlerës së truallit, me kërkesë të pronarit të shpronësuar të tij.

4. Në kontratat e qirasë ose të enfiteozës, të lidhura për pasuri ku sipërfaqja e truallit është mbi 500 m², në rastet kur shoqëria qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse ka kryer investime në përputhje me planbiznesin dhe në masën mbi 150 për qind të vlerës së truallit, si dhe kur shoqëria ka respektuar kushtet e kontratës, subjekteve kontraktuese, që kanë konsumuar mbi 5 vjet të kontratës, u lind e drejta e privatizimit të drejtpërdrejtë të objektit të kontratës, sipas legjislacionit në fuqi.

Titullari i institucionit, që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës, urdhëron ngritjen e grupit për vlerësimin e investimeve të kryera, të përbërë nga një ekspert vlerësues i licencuar dhe një ekspert kontabël i autorizuar, të cilët hartojnë raportin për vlerësimin e investimeve të kryera nga shoqëria qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse për periudhën nga lidhja e kontratës deri në bilancin e vitit të fundit ushtrimor të miratuar. Në rastet kur objekti, para lidhjes së kontratës së qirasë ose të enfiteozës,



është përdorur me qira nga i njëjti subjekt, me të njëjtin qëllim, por me kontrata me afat më të vogël, ekspertët vlerësues të investimeve, në hartimin e raportit përkatës përfshijnë edhe investimet e kryera nga ky subjekt gjatë asaj periudhe.

Me marrjen e raportit të ekspertëve, drejtoria përgjegjëse për monitorimin e kontratave të qirasë ose të enfiteozës bën krahasimin e vlerës së truallit të përcaktuar sipas çmimit të përcaktuar në vendimin nr. 187, datë 6.3.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Shqipërisë”, me vlerën e investimeve të kryera në objekt, sipas raportit të ekspertëve dhe ia paraqet ministrit. Kur vlera e investimeve është mbi 150 për qind e vlerës së truallit, ministri miraton fillimin e procedurave për privatizim të drejtpërdrejtë të objektit.

Në rastet kur për pasurinë, objekt i kontratës së qirasë, të drejtën e ushtrimit të përfaqësuesit të pronës shtetërore e ushtron pushteti vendor, atëherë ky organ i pushtetit vendor që ka lidhur kontratën kryen procesin e vlerësimit të investimeve deri në konkluzionin se vlera e investimeve të kryera nga sipërmarrësi është mbi 150 për qind e vlerës së truallit, sipas procedurave të mësipërme, dhe, më pas, ia përcjell ministrisë përgjegjëse për ekonominë me propozimin për privatizim të drejtpërdrejtë të asaj pasurie.

Pagesa e ekspertëve, që hartojnë raportin e vlerësimit të investimeve të kryera nga qiramarrësit, do të jetë 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo ekspert dhe, për çdo rast, urdhërohet nga titullari i institucionit urdhëruar të misionit të vlerësimit të investimeve.

5. Në rastet kur janë plotësuar kushtet për privatizim të drejtpërdrejtë, si më lart, dhe objektet e dhëna me qira ose enfiteozë janë pjesë e kapitalit të shoqërive shtetërore, para fillimit të procedurave të privatizimit, bëhet zbritja e tyre nga kapitali i shoqërisë shtetërore.

IX. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Vendimi nr. 529, datë 8.6.2011 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira ose enfiteozë të pronës shtetërore”, dhe aktet në zbatim të tij, shfuqizohen.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ministritë e linjës dhe institucionet qendrore e organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA A
TARIFAT DYSHEME TË QIRASË MUJORE PËR NDËRTESAT SIPAS PREFEKTURAVE
lek/m²

Prefektura	Specifikimi territorial	Tarifa dysheme
Berat	Në Bashkinë Berat	100
	Jashtë Bashkisë Berat	50
Dibër	Në Bashkinë Dibër	75
	Jashtë Bashkisë Dibër	50
Durrës	Brenda Bashkisë Durrës	200
	Jashtë Bashkisë Durrës	150
Gjirokastrë	Brenda Bashkisë Gjirokastrë	75
	Jashtë Bashkisë Gjirokastrë	50
Elbasan	Brenda Bashkisë Elbasan	150
	Jashtë Bashkisë Elbasan	75
Fier	Brenda Bashkive Fier, Lushnjë	150
	Jashtë Bashkive Fier, Lushnjë	100
Korçë	Brenda Bashkisë Korçë	150

	Jashtë Bashkisë Korçë	75
Lezhë	Brenda Bashkisë Lezhë	150
	Jashtë Bashkisë Lezhë	100
Kukës	Brenda Bashkisë Kukës	75
	Jashtë Bashkisë Kukës	50
Shkodër	Brenda Bashkisë Shkodër	150
	Jashtë Bashkisë Shkodër	100
Vlorë	Brenda Bashkisë Vlorë	200
	Jashtë Bashkisë Vlorë	100
Tiranë	Brenda Bashkisë Tiranë	300
	Jashtë Bashkisë Tiranë	150

TABELA B
TABELA E TARIFAVE TË QIRASË MUJORE TË PASURIVE NË ADMINISTRIM TË
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERTARE

Tarifat minimale mujore të vilave e të objekteve të jenë:

Nr.	Vilat dhe objektet	Njësia e matjes	Me pajisje	Pa pajisje	Bodrum	Kopsht	Garazh
1	Super kategori	lekë/m ²	1.800	1.500	300	150	
2	Kategori ekstra	lekë/m ²	700	500	150	150	
3	Kategori I	lekë/m ²	600	400	150	150	
4	Kategori II	lekë/m ²	500	300	150	150	
5	Kategoria III	lekë/m ²	400	200	150	150	
6	Kategoria IV	lekë/m ²	200	150			200

Tarifat minimale të qirasë, të mjediseve për Pallatin e Kongreseve, të jenë:

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Tarifat pa TVSH
I	Dhënie zyresh me qira		
A	Me pajisje	lekë/m ² /muaj	2.000
B	Pa pajisje	lekë/m ² /muaj	1.500
II	Dhënie sallash me qira për 8 orë (1 ditë)		
A	Salla e koncerteve ditë aktiviteti	lekë	450.000
B	Salla e koncerteve ditë përgatitore	lekë	112.500
C	Salla e kinemasë për 1 ditë	lekë	80.000
D	Salla me përkthim për 1 ditë	lekë	100.000
E	Sallat e vogla për 1 ditë	lekë	45.000
F	Konferencë shtypi minimumi 1 orë	lekë/orë	13.500
III	Dhënie hollesh me qira për 8 orë (1 ditë)		
A	Holli kuota 0	lekë/m ² /ditë	100
B	Holli kuota 1	lekë/m ² /ditë	300
C	Holli kuota 2	lekë/m ² /ditë	250
D	Holli kuota 3	lekë/m ² /ditë	250



VENDIM
Nr. 56, datë 5.2.2014

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 600, DATË 12.9.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR TRAJTIMIN ME STREHIM TË NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SË LARTË
SHTETËRORE DHE TË FUNKSIONARËVE POLITIKË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendimi nr. 600, datë 12.9.2007 i Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, i ndryshuar, dhe çdo akt tjetër nënligjor i nxjerrë në zbatim të tij, shfuqizohet.

2. Fondet e programuara për trajtimin me strehim sipas vendimit nr. 600, datë 12.9.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, do të kalojnë për trajtimin me strehim të kategorive më në nevojë.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 58, datë 5.2.2014

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF013194, TË FONDIT GLOBAL TË
MJEDISIT (GEF), NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “RAPORTIMI PËR
KONVENTAT, HARMONIZIMI I PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR TË LUFTUAR
SHKRETËTIRËZIMIN NË SHQIPËRI DHE PËRGATITJEN E RAPORTIT KOMBËTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF013194, të Fondit Global të Mjedisit (GEF), ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit “Raportimi për konventat, harmonizimi i Planit Kombëtar të Veprimit për të luftuar shkretëtirëzimin në Shqipëri dhe përgatitjen e raportit kombëtar”, nëpërmjet një granti prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) USD, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Banka Botërore
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE E ZHVILLIMIT

1818 H Street N.W.
Washington D.C. 20433
SHBA

(202) 477 - 1234
Adresa me kablo: INTBAFRAD
Adresa me kablo: INDEVAS
27 nëntor 2012

Shkëlqesisë së tij, z. Ridvan Bode
Ministër i Financave,
Ministria e Financave
“Dëshmorët e Kombit”, nr. 4
Tiranë
Republika e Shqipërisë

Referuar: raporteve GEF për grantin e konventave nr. TF013194
Harmonizimi i planit kombëtar të veprimit për të luftuar krijimin e tokave të shkreta në Shqipëri
dhe përgatitja e raportit kombëtar

Shkëlqesi,

Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare në emër të Republikës së Shqipërisë (Marrësi), kam kënaqësinë t’ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv/(COE) i Facilitetit Global të Mjedisit (GEF), propozon që t’i japë Marrësit një grant nga raportet e dritares së konventave të fondit trust GEF në një shumë që nuk i kalon njëqind e pesëdhjetë mijë dollarë të Shteteve të Bashkuara (U.S.\$150,000) (Granti) me termat dhe kushtet e parashikuara ose që referohen në këtë letër marrëveshjeje (Marrëveshja), që përfshin shtojcat e bashkëlidhura, për të asistuar në financimin e projektit të përkthuar në shtojcë (Projekti).

Ky Grant financohet nga fondi trust GEF për të cilin Banka Botërore, si dorëzane e fondit, merr kontribute periodike. Në përputhje me seksionin 3.02 të Kushteve Standarde (siç përcaktohet në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e Bankës Botërore për pagesën në lidhje me këtë Marrëveshje, janë të kufizuara me shumën e fondeve që i vihen asaj në dispozicion nga fondi trust GEF, dhe e drejta e Marrësit për të tërhequr paratë e Grantit i nënshtrohen disponueshmërisë së këtyre fondeve.

Marrësi përfaqëson, duke konfirmuar marrëveshjen e tij më poshtë, se ai është i autorizuar që të hyjë në këtë Marrëveshje dhe të realizojë Projektin në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara ose të referuara në këtë Marrëveshje. Në përputhje me kuptimin e pasqyruar në paragrafët 23-24 të dokumentit të Këshillit të GEF (GEF/C.38/6/Rev.1) për politikën dhe procedurat për ekzekutimin e aktiviteteve të përzgjedhura GEF, Marrësi njeh, gjithashtu, se, në qoftë se ndonjë prej projekteve/programeve të identifikuar si një rezultat i Projektit financohet me fondet GEF, projektet, programet në fjalë duhet të përputhen me kërkesat e aplikueshme mjedisore dhe sociale.

Ju lutemi, konfirmoni që Marrësi është dakord me sa më sipër, duke e pasur një zyrtar të autorizuar të Marrësit që të nënshkruajë dhe të vërë datën në kopjen e bashkëlidhur të kësaj Marrëveshjeje dhe t’ia kthejë atë Bankës Botërore. Me marrjen e kopjes së kundërfirmosur nga Banka Botërore, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e kundërfirmosjes, sidoqoftë, me kushtin që ofrimi i kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohet i tërhequr, në qoftë se Banka Botërore nuk e ka marrë kopjen e kundërfirmosur të kësaj Marrëveshjeje brenda tridhjetë (30) ditësh pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Banka Botërore, me përjashtim të rastit kur Banka Botërore të këtë vendosur një datë të mëvonshme për këtë qëllim.

E juaja vërtet,

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Naoko Ishii

Administratori/kryetari, Lehtësia Globale e Mjedisit



RËNË DAKORD:
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga _____
Përfaqësues i autorizuar

Emri -----

Titulli -----

Data -----

Bashkëlidhur:

1. Kushtet standarde për grantet e bëra nga Banka Botërore prej fondeve të ndryshme, datë 15 shkurt 2012.

2. Letër disbursimi i së njëjtës datë me këtë Marrëveshje, bashkë me Udhëzimet e Disbursimit për Projektet e Bankës Botërore, datë 1 maj 2006.

GEF-RtCs Grant nr. TF013194

SHTOJCË

Neni I

Kushtet Standarde; Përkufizimet

1.01. Kushtet Standarde. Kushtet standarde për Grantet e bëra nga Banka Botërore nga Fonde të Ndryshme, të datës 15 shkurt 2012 (Kushtet Standarde) janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

1.02. Përkufizime. Po qe se nuk e kërkon konteksti ndryshe, termat me germa të mëdha, të përdorura në këtë Marrëveshje, kanë kuptimet që u jepen atyre në Kushtet Standarde ose në këtë Marrëveshje.

Neni II

Ekzekutimi i Projektit

2.01. Objektivi dhe Përshkrimi i Projektit: a) Përshtatja e Programit Kombëtar të Veprimit (NAP) me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Luftuar Krijimin e Tokave të Shkreta (UNCCD) Strategjia 10-vjeçare; dhe b) respektimi i kërkesave raportuese dhe rishikuese të UNCCD-së.

b) Projekti përbëhet nga aktivitetet e mëposhtme: i) kryerja e rishikimit, vlerësimit të NAP-it dhe rritja e ndjeshmërisë për përshtatjen e NAP-it; ii) forcimi i kapacitetit njerëzor dhe shkencor për përshtatjen e NAP-it; iii) krijimi dhe forcimi i kuadrit politik dhe institucional për përshtatjen dhe implementimin e NAP-it; dhe krijimi i kuadrit të financës dhe të teknologjisë për implementimin e NAP-it; iv) forcimi i kapacitetit njerëzor dhe shkencor për implementimin e monitorimit dhe vlerësimit të bazuar te treguesit; v) përgatitja e raporteve për proceset e raportimit dhe rishikimit të UNCCD-së (2012) të 5-të; dhe vi) rritja e pronësisë kombëtare të procesit të raportimit, dhe harmonizimi i të dhënave të treguesve dhe bazave të njohurive të GEF-it, Informacionin e Marrëveshjes Shumëpalëshe të Mjedisit dhe Menaxhimin e Njohurive (MEA IKM) dhe të tjera baza të dhënash që lidhen me degradimin e tokës.

2.02 Ekzekutimi i Projektit në Përgjithësi. Marrësi deklaron angazhimin e tij për objektivin e Projektit. Për këtë qëllim, Marrësi do të realizojë Projektin nëpërmjet Ministrisë së tij të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në përputhje me dispozitat e: a) Nenit II të Kushteve Standarde; b) "Udhëzimet për Parandalimin dhe Luftimin e Mashtrimit dhe Korrupsionit në Projektet e Financuara nga Huat e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-s", të datës 15 tetor 2006 dhe rishikuar në janar 2011 (Udhëzimet kundër Korrupsionit); dhe c) këtë nen II.

2.03 Dukshmëria dhe Vizitat e Donatorit: a) Marrësi do të marrë ose do të bëjë që të merren ato masa që Banka Botërore mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të identifikuar publikisht mbështetjen e GEF-it për Projektin.

b) Për qëllimet e seksionit 2.09 të Kushteve Standarde, me kërkesën e Bankës Botërore, përfaqësuar nga Administratori i GEF-it, Marrësi do t'u mundësojë përfaqësuesve të GEF-it të vizitojnë çdo pjesë të territorit të Marrësit për qëllimet që lidhen me Projektin.

2.04 Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi i Projektit. Marrësi do të monitorojë dhe vlerësojë ecurinë e Projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të Kushteve Standarde. Pa kufizim, për sa më sipër, Marrësi do t'i dorëzojë Konferencës UNCCD të Palëve, me një njoftim të menjëhershëm për Bankën Botërore, NAP-i i përshtatur me Strategjinë 10-vjeçare të UNCCD-së dhe raportin për proceset e raportimit dhe rishikimit të UNCCD (2012) të 5-të; që përmenden në seksionin 2.01 të kësaj Marrëveshjeje, jo më vonë se një muaj para Datës së Mbylljes të Specifikuar në seksionin 3.03 të kësaj Marrëveshjeje.

2.05 Menaxhimi Financiar: a) Marrësi do të sigurojë që të mbahet një sistem i menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të Kushteve Standarde.

b) Marrësi do të sigurojë që të përgatiten dhe t'i dorëzohen Bankës Botërore raportet e ndërmjetme të paaudituar financiare për Projektin jo më vonë se 45 ditë pas fundit të çdo tremujori kalendarik që të mbulojnë tremujorin, në një formë dhe përmbajtje që të plotësojë kërkesat e Bankës Botërore.

c) Marrësi do të auditojë deklaratat financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 (b) të Kushteve Standarde. Çdo audit i deklaratave financiare do të mbulojë secilin vit fiskal të Marrësit, gjatë të cilit janë bërë tërheqje nga Llogaria e Grantit. Deklaratat financiare të audituara për çdo periudhë do t'i dorëzohen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas fundit të kësaj periudhe.

2.06 Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat, shërbimet jokonsulente dhe shërbimet konsulente që kërkohen për Projektin dhe që do të financohen nga paratë e Grantit do të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashtruara dhe të referuara në:

i) Seksionin I të "Udhëzimeve: Prokurimi i Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve Jokonsulente sipas Huave të IBRD-së dhe Kredive dhe Grandeve IDA", të janarit 2011 (Udhëzimet e Prokurimit), në rastin e mallrave dhe shërbimeve jokonsulente;

ii) Seksionin I dhe IV të "Udhëzimeve: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve sipas Huave IBRD dhe Kredive dhe Granteve IDA nga Huamarrësit e Bankës Botërore" e janarit 2011 (Udhëzime për Konsulentët) në rastin e shërbimeve konsulente; dhe

iii) Dispozitat e këtij seksioni, si të njëjta do të përpunohen në planin e prokurimit të përgatitur dhe të përditësuar herë pas here nga Marrësi për Projektin në përputhje me paragrafin 1.18 të Udhëzimeve të Prokurimit dhe paragrafit 1.25 të Udhëzimeve të Konsulentit (Plani i Prokurimit).

b) Përkufizimet. Termat me germa të mëdha të përdorura në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni, për të përshkruar metodat e veçanta të prokurimit ose metodat e rishikimit nga Banka Botërore për kontrata të veçanta, i referohen metodës korresponduese, të përshkruara në seksionet II dhe III të Udhëzimeve të Prokurimit ose seksioneve II, III, IV dhe V të Udhëzimeve për Konsulentin, si të jetë rasti.

c) Metodatat e Veçanta të Prokurimit të mallrave dhe të shërbimeve jokonsulente. Metodatat e mëposhtme mund të përdoren për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve jokonsulente për ato kontrata që specifikohen në planin e prokurimit: A) Blerjet; dhe B) Kontraktimi i Drejtpërdrejtë.

d) Metodatat e Veçanta të Prokurimit të Shërbimeve Konsulente. Metodatat e mëposhtme mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato detyra që specifikohen në Planin e Prokurimit: A) Përzgjedhje e Bazuar në Kualifikimet e Konsulentëve; B) Përzgjedhja me Burim të Vetëm të Firmave Konsulente; C) Përzgjedhja e Konsulentëve Individualë; dhe D) Procedurat me Burim të Vetëm për Përzgjedhjen e Konsulentëve Individualë.

e) Rishikimi nga Banka Botërore i Vendimeve të Prokurimit. Plani i Prokurimeve do të parashikojë ato kontrata, të cilat do t'i nënshtrohen Rishikimit Paraprak të Bankës Botërore, në qoftë se është e aplikueshme. Të gjitha kontratat e tjera do t'i nënshtrohet rishikimit të mëvonshëm nga Banka Botërore.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 28 lekë